



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 02.12.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Brunilda Kadi* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Illir Toska* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
8. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk merrnin pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Medi Bici dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Fatmira Luli.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat e qarqeve Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, lidhur me mbledhjen e parashikuar sot nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nisur nga situata urgjente që është shpallur për shkak të fatkeqësisë natyrore të tërmetit të shkaktuar më datë 26 nëntor 2019.

Prezent në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të gjithë anëtarët, përveç zotit Medi Bici, i cili ka një fatkeqësi familjare për shkak të tërmetit, dhe zonjës Fatmira Luli, e cila për arsye shëndetësore nuk ndodhet në këtë mbledhje.

Atëherë, siç ju vura në dijeni, më datë 26 nëntor 2019 ka ndodhur një tërmet në vend dhe për pasojë Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 ka shpallur fillimisht gjendjen e emergjencës për qarqet Durrës dhe Tiranë dhe më vonë, me ndryshim të këtij vendimi, ka shpallur gjendjen e emergjencës edhe për qarkun e Lezhës.

Nisur nga situatat e konstatuara në këto qarqe dhe nga informacionet e marra nga kryetarët e gjykatave në qarqet respektive, nga ana e Këshillit është propozuar, ose më mirë, në cilësinë e Kryetares, i propozoj Këshillit një vendimmarrje lidhur me pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat në qarqet respektive për të cilat është shpallur gjendje emegjence. Më konkretisht, atë që unë ju propozoj dhe ju ftoj për vendimmarrje është që: Të pezullohet veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore në gjykatat ku ushtrojnë veprimtarinë në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Ndërkohë, të përjashtohen nga pezullimi i kësaj veprimtarie të gjithë çështjet me natyrë të ngutshme, shqyrtimi i të cilave mund të zhvillohet edhe në ambiente të tjera jashtë gjykatës, por duke patur parasysh që të ofrohet siguria.

Gjithashtu, ajo që gjykohet e arsyeshme është që kohëzgjatja e këtij pezullimi do të jetë deri në një moment kur autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësimin e kushteve ekzistuese të riskut të ambienteve si dhe të garantohet eliminimi i çdo rrishtu të mundshëm që mund të çojë në dëmtimin e jetëve njerëzore ashtu dhe të pronës.

Në përfundim të projekt-aktit: Kryetarët e gjykatave të ngarkohen të marrin të gjithë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Nëse keni ndonjë gjë për të sugjeruar apo për të shtuar lidhur me këtë propozim, ju jap fjalën.

Jo!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-propozimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: “Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykatat të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të ndodhur nga tërmeti i datës 26.11.2019.

Përfundohet nga efektet e këtij pezullimi veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore, që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, shqyrtimi i të cilave mund të zhvillohet edhe në ambiente të tjera jashtë gjykatës të cilat ofrojnë siguri.

Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë deri në momentin kur autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësimin e kushteve ekzistuese të rrishtu të ambienteve të gjykatës dhe të garantohet eliminimi i çdo rreziku të mundshëm që mund çojë në dëmtim të jetëve njerëzore ashtu dhe të pronës.

Kryetarët e gjykatave ngarkohen të marrin të gjithë masat për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit

të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, atëherë mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor